

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama në OKB për rreziqet e IA: Jo frenim, por marrëveshje ndërkombëtare! Ky s
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/live-asambleja-e-okb-mban-fjalimin-kryeministri-edi-rama?r=kh1
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:37:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 17:31:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	93758fe522997e11588cb5237edcd3a03708287c7fa0f36f0f26f71b6eb9a4bc
TEKSTI	0db8e432a09d322b3e3f023cc479d9e90f6989b87b876fe61b8ad6e0f9923b7a
PAMJA	805d3fe9c701f425c352a8b7b267e4bf4008d101e010a15706bf6460076a239d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	689ffb2ac9763861fe04468ee5192884580a58cca49bf467888761fcdef01135
E MËPARSHMJA	f0d667fb01bb02403df5066fda1ce8474ffb8bdac2a2f03a93fbe7cb25fa97fa
RRËNJA MERKLE	9fd2d6c8eaed582dbfbd973ad421bf483fa1abd0a548cdf1a11aa95128494a7b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/689ffb2ac9763861fe04468ee5192884580a58cca49bf467888761fcdef01135>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Itali/ Kufizimi i nxënësve të huaj në klasa, kryebashkiakja e Pieve di Cadore: Erdha nga Shqipëria kur isha në klasë të katërt, vitin tjetër ndihmoja shokët

Politikë

Rama në OKB për rreziqet e IA: Jo frenim, por marrëveshje ndërkombëtare! Ky s'do të jetë shekulli i makinerisë! Narrativa për pushtimin e bregdetit shqiptar nga Izraeli nxiti protestat në Tiranë

Kryeministri u shpreh me keqardhje ndaj atyre që mendojnë se për shkak të rreziqeve, Inteligjenca Artificiale duhet të ngadalësohet. Shqipëria është pro përparimit të saj, tha ai, por nevojiten rregulla duke propozuar më tej edhe një marrëveshje ndërkombëtare për kontrollin e IA.

- Fjala e PLOTË/ Edi Rama në OKB: Makineria e Inteligjencës Artificiale do të bindet, pyetja është 'kujt'
- Rama në OKB: Liria e shprehjes po kërcënohet nga përdorimi si armë i 'fuqisë së shpërndarjes!'
- Protestat në Tiranë, Rama nga OKB-ja: U fabrikua një narrativë për 'pushtimin izraelit' të bregdetit shqiptar, qytetarët protestuan kundër një fantazme
- Rama në OKB: Inteligjenca Artificiale mund të fabrikojë realitetin! Rreziku më i madh, të bindë njerëzit e gabuar
- Rama në OKB: Inteligjenca artificiale duhet të jetë në shërbim të njeriut, jo anasjelltas! Solli ministren virtuale, algoritmi nuk mban përgjegjësi



Redaksia

25 Shtator, 19:29 | Përditësimi: 25 Shtator, 20:53

f Share Tweet

A A

Në fjalimin e tij përpara Asamblesë së OKB-së, kryeministri [Edi Rama](#) iu bashkua mendimeve të liderëve të tjerë botërorë për rreziqet e Inteligjencës Artificiale dhe manipulimet që ajo prodhon.

Duke marrë si shembull "Flamingo Revolution", kryeministri tha se ishte veçse një narrativë e fabrikuar falë Inteligjencës Artificiale për të treguar një pushtim izraelit që më pas u amplifikua dhe prodhoi pasojat e saj.



"Jam i bindur se ju e keni ndjekur revolucionin e flamingove, një narrativë e fabrikuar për pushtimin izraelit të bregdetit shqiptar, një pushtim që s'ka ndodhur kurrë, por kjo u fabrikua dhe u përcoll përmes zërave, faqeve dhe kanaleve. Qytetarët i kanë besuar tashmë. Qytetari mori një histori të tradhtisë kombëtare, një tjetër të provokimit fetar, një tjetër për një pushtim të jashtëm. Fabrikime të ndryshme u futën në botë të ndryshme emocionale dhe të gjitha i shërbenin gënjeshtërs strategjike. Pasojat ishin reale. Qytetarët kishin arsyt për të protestuar, por ata papritur ishin duke protestuar kundër një fantazme tashmë", tha Rama.



LEXO EDHE:

Fjala e PLOTË/ Edi Rama në OKB: Makineria e Inteligjencës Artificiale do të bindet, pyetja është 'kujt'



Kryeministri u shpreh me keqardhje ndaj atyre që mendojnë se për shkak të rreziqeve, [Inteligjenca Artificiale](#) duhet të ngadalësohet. Shqipëria është pro përparimit të saj, vijoi ai, por nevojiten rregulla.



"Ne jemi kundër. Ne nuk mund të rregullojmë veten tonë deri në pafuqi. Për këtë pyetje, presidenti i SHBA-ve ka të drejtë, duhet të përshpejtojmë. IA në shërbim të qytetarëve, të përgjegjshme. Përgjigjja është kapacitet demokratik", tha Rama.

Sipas tij, këto rregulla duhet të jenë një përgjigje e qartë nga të gjitha vendet duke ushtruar kontroll mbi makinerinë dixhitale.



"Shqipëria bën thirrje për një marrëveshje ndërkombëtare dhe për një inteligjencë artificiale secure. Siguriteti dixhital s'mund të jetë privilegj i rezervuar në shtetet më të reja."



“...Sot, me transformimin e makinerisë në një përpjekje të re për shtet me të pasura. Gënjeshtrat udhëtojnë pa viza. Algoritmet i kapërcejnë kufijtë pa pasur nevojë për pasaportë”, tha kryeministri.

Në fund, ai u shpreh se do të jenë njerëzit ata që do të vendosin mbi lirinë apo manipulimin nga Inteligjenca Artificiale pasi në fund të fundit, makineria do të bindet.

“AI nuk vendos nëse ky shekull i përket lirisë apo manipulimit. Ne e vendosim. Makineria do të bindet. Pyetja është se kujt do t'i bindet, cilit ligj dhe për çfarë qëllimi”, tha Rama.

Rendit zhvillimet sipas orarit: [Të Fundit](#)

Ora 20:42

Balla nga SHBA: Me Edi Ramën Shqipëria është ngjitur në majën më të lartë të historisë së shtetit shqiptar



Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, është shprehur se Shqipëria nën qeverisjen e kryeministrit Edi Rama është ngjitur në majën më të lartë të historisë së shtetit shqiptar.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, ku ka publikuar edhe një fotografi krah kryeministrit Rama, Balla ka shkruar se transformimi i institucioneve, forcimi i shtetit të së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit janë procese që kanë fituar vëmendje dhe vlerësim të shtuar nga partnerët e vendit tonë, Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara.

Balla 'thumboi' edhe partitë opozitare, të cilat i quajti 'humbës kronikë', teksa shtoi se lufta kundër korrupsionit nuk bëhet me sharje dhe vezë, por përmes institucioneve.

Për Ballën, koha e propagandës dhe e baltës politike nuk mund të ndalë rrugën Europiane të Shqipërisë, që tashmë sipas tij, ka hyrë në një fazë të re.

Reagimi i Ballës:

Me Edi Ramën Shqipëria është ngjitur në majën më të lartë të historisë së shtetit shqiptar. Sot Shqipëria nuk është më ajo e së shkuarës. Transformimi i institucioneve, forcimi i shtetit të së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit janë procese që kanë fituar vëmendje dhe vlerësim të shtuar nga partnerët tanë strategjikë, Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara.

Përballë këtij realiteti të ri, vazhdojnë zhurma politike e mediatike dhe rikthehen shpresat e humbura të humbësve kronikë. Por lufta kundër korrupsionit nuk bëhet me retorikë, sharje apo vezë, por përmes institucioneve dhe një sistemi që po ndërtohet pikërisht për të garantuar më shumë transparencë, përgjegjshmëri dhe drejtësi. Ku secili ka përgjegjësinë e tij civile, penale, morale. Kaq!

Koha e propagandës dhe e baltës politike nuk mund të ndalë rrugën tonë Europiane që tashmë ka hyrë në një fazë të re.

R.Xh/Shqiptarja.com

[f Share](#)

Ora 20:07

Rama në OKB: Inteligjenca Artificiale nuk vendos nëse ky shekull i përket lirisë apo manipulimit! Makineria do të bindet, pyetja është kujt





Inteligjenca Artificiale nuk do të vendosë nëse ky shekull do t'i përkasë lirisë apo manipulimit, por këtë do ta vendosin njerëzit. Kështu deklaroi kryeministri Edi Rama nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, duke theksuar se makineria do të bindet, ndërsa sfida është se kujt, cilit ligj dhe për çfarë qëllimi do t'i shërbejë.



"Të dashur miq, çdo brezi i bëhet thirrje të mbrojë lirinë në një territor ku liria është nën kërcënim. Për një brez territori ishte fushëbeteja, për një tjetër ishte kutia e votimit. Për tonin është shumë i qartë, është mendja njerëzore. Le të sigurohemi që asnjë qytetar të mos lihet i vetëm përballë një ushtrie gjithmonë e më tmerruese algoritmike, le të sigurohemi që asnjë komb i vogël të mos detyrohet të huazojë kuptimin e realitetit nga jashtë kufijve të vet. Le të sigurohemi që asnjë demokraci të mos zgjohet pa asnjë palë zgjedhjeje për të zbuluar se qytetarët e vetë kanë ushtruar lirinë e tyre të zgjedhjes brenda një bote të projektuar në mënyrë të fshehtë për ta nga dikush që as nuk mund ta shohin e as nuk e dinë që është fuqia pas zgjedhjes së tyre. Inteligjenca artificiale nuk do të vendosë nëse ky shekull i përket lirisë apo manipulimit. Ne do ta vendosim. Makina do të bindet. Pyetja është kujt do t'i bindet? Sipas cilit ligj dhe në shërbim të cilit qëllim njerëzor.

Shqipëria e ka bërë zgjedhjen e vetë modeste. Ne kemi zgjedhur përshpejtimin, jo dorëzimin. Kemi zgjedhur inovacionin, jo abdikimin. Kemi zgjedhur rritjen e jo atrofizimin e aftësisë njerëzore. Kemi zgjedhur lirinë e shprehjes. E dimë ç'do të thotë të jetosh pa të. E pikërisht sepse e kemi zgjedhur, refuzojmë ta ngatërrojmë me lirinë e pakontrolluar të makinave, parave dhe fuqive të huaja për të mbërritur te gjithkush gjithkund pa asnjë llogari. Ne zgjedhim të vërtetën jo sepse e vërteta është gjithmonë e lehtë apo e rehatshme, por sepse pa një angazhim të përbashkët ndaj realitetit nuk mund të kemi një jetë të përbashkët publike. E pa këtë angazhim prej të gjithëve ne ndaj realitetit të botës ku jetojmë do të jemi të angazhuar. Do të përfshihemi në tradhtinë më të tmerrshme që prindërit e kësaj bote në historinë e njerëzimit do të kenë bërë kundrejt fëmijëve të tyre. E pa një botë të përbashkët nuk mund të ketë Kombet e Bashkuara. Këtu përfundon predikimi im në shkretëtirë dhe shpresa që kam që është në fakt vendi i fundit ku mbështetem", tha Rama.

SL.E./Shqiptarja.com

f Share

Ora 19:52

Asambleja e OKB, Rama për IA: Jemi kundër kufizimit, propozojmë marrëveshje ndërkombëtare për sovranitetin e saj



Duke u nisur nga debatet mbi debatet për kufizimin e inteligjencës artificiale, kryeministri Rama tha në OKB se Shqipëria është kundër këtij qëndrimi. Ai tha se nevojitet sovraniteti dixhital që shtetet të ndërtojnë sisteme mbrojtjeje nga manipulimet. Më tej, propozoi marrëveshje ndërkombëtare për IA më sovrane.

Kryeministri u shpreh se kjo s'mund të jetë vetëm privilegj i vendeve të pasura pasi gënjeshtra udhëton kudo.



"Disa përgjigjen duke kërkuar që inteligjenca artificiale të ndalet apo të ngadalësohet. Ne jemi shumë të vegjël, por më shumë respekt nuk do të biem dakord. Një pauzë nga demokracitë nuk do të sjellë pauzë nga diktaturat. Një moratorium i respektuar nga shtetet të përgjegjshme nuk do të kufizojë fuqitë armiqësore, rrjetet ndërkombëtare kriminale apo industritë e manipulimit. Ne nuk mund të rregullojmë veten tonë deri në pafuqi. Për këtë pyetje thelbësore strategjike, presidenti i SHBA-së ka të drejtë, nuk duhet të ndalemi, duhet

të përshejtojmë, por përshejtimi duhet të ketë një drejtim. Na duhet një inteligjencë artificiale që është e verifikueshme, transparente dhe llogaridhënëse, e ndërtuar nga shoqëri të lira, ndarë mes aleatësh dhe vënë në shërbim të qytetarëve.

Përgjigjja përkundrejt përdorimit të automatizimit si armë nuk është dorëzimi teknologjik, është kapaciteti demokratik, është aftësia sovrane, është një inteligjencë e mirë artificiale në duart e atyre që mbeten llogaridhënës përkundër legjislacionit. Një inteligjencë sovrane artificiale nuk do të thotë izolim, do të thotë që asnjë vend të mos jetë i pafuqishëm përpara sistemeve që nuk mund të kuptojë, të kontrollojë apo t'i pranojë pa i sfiduar ato. Çdo vend duhet të jetë i aftë të mbrojë gjuhën e vet, komunikimet autentike, të autentifikojë komunikimet publike, të zbulojë manipulimet e koordinuara, të ruajë të dhënat e të informojë qytetarët e vet pa u varur krejtësisht nga përparësitë tregtare të një korporate të largët.

Ja pse Shqipëria, në shkallën e vet mikroskopike përkundrejt kësaj sfide gjigante, po ndërton një pasqyrë digjitale mbështetur mbi inteligjencën artificiale. Pasqyra do të identifikojë manipulimin në kohë reale, do të testojë pretendimet, krahasuar me informacionin e autorizuar, do të zbulojë strukturat e koordinuara, jo vetëm ato çfarë shihen, por edhe si e pse ka mbërritur tek ta. Nuk do t'u thotë qytetarëve se çfarë duhet të mendojnë. E drejta nuk mund të dekretohet nga asnjë qeveri. Duhet të jetë e mbështetur në të dhëna. Të nxirret nga burimet e dhura, të testohet, të sfidohet dhe të mbrohet haptazi. Pasqyra jonë nuk synon të shndërrohet në arbitër opinionit. Ka për synim të shndërrohet në një infrastrukturë transparence. Nuk kërkon të krijojë një ministri të së vërtetës, largqoftë, por kërkon të mbrojë shoqërinë kundër një industrie gënjeshttrash. Për rrjedhojë, Shqipëria bën thirrje për një marrëveshje ndërkombëtare për një inteligjencë artificiale sovrane e demokratike.

Së pari, qytetarët duhet të dinë kur përmbajtja politike me ndikim është gjeneruar artificialisht apo është manipuluar në përmbajtjen e saj. Së dyti, arkitektura e shpërndarjes duhet të bëhet transparente. Qytetarët dhe shtetet duhet të kenë mundësi të dinë kush e krijoi, financoi, kush e shënjestroi apo amplifikoi artificialisht përmbajtjen politike me ndikim. Së treti, çdo përdorim me ndikim i inteligjencës artificiale nga një institucion publik duhet të ruajë një zinxhir të qartë llogaridhënieje njerëzore ligjore. Së katërti, demokracitë duhet të krijojnë një sistem të përbashkët paralajmërimi të hershëm në mënyrë që të dhënat e manipulimit të drejtuar nga Inteligenca Artificiale të mund të rrugëtojnë midis të gjitha vendeve me mendësi të njëjtë po aq shpejt sa dhe vetë manipulimi. Si vende më të vogla e gjuhë të vogla, nuk duhet të braktisen jashtë kësaj "arkitekture" mbrojtëse. Sovraniteti digjital nuk mund të jetë një privilegj edhe njëherë rezervuar për shtetet më të pasura.


Gënjeshttrat "udhëtojnë" pa viza. Gënjeshttrat nuk duan t'ia dinë për mure, për kontrollë kufiri. Algoritmet i kapërcejnë kufijtë pa pasur nevojë për ndonjë pasaportë e pa frikën e ndonjë lloj qeverie. Ata që sulmojnë vendet tona bashkëpunojnë tashmë përtej juridiksioneve. Vendet tona, demokracitë tona së pari e mbi të gjitha, duhet të mësojnë të bëjnë të njëjtën gjë. Kjo nuk është në fund të fundit një garë midis njerëzimit dhe makinave, është një garë midis qëllimeve të ndryshme njerëzore, secili prej të cilave amplifikohet nga makinat; midis atyre që përdorin Inteligjencën Artificiale për të ndriçuar dhe atyre që e përdorin për të mbjellë terr; midis atyre që e përdorin për të fuqizuar njerëzit, qytetarët e tyre dhe atyre që e përdorin për t'i manipuluar ata, midis atyre që pranojnë përgjegjësi dhe atyre që fshihen pas automatizimit. Nuk duhet të trembeni që makinat do të bëhen më njerëzore. Duhet të kemi frikë që qeniet njerëzore të mos bëhen të padukshme pas makinave", tha Rama.

P.J/Shqiptarja.com

f Share

Ora 19:47

Kryeministri Rama në OKB: Liria e shprehjes po kërcënohet nga përdorimi si armë i 'fuqisë së shpërndarjes'! Kur një gënjeshtër shumëfishohet, e vërteta varroset



Kryeministri Edi Rama është shprehur gjatë fjalës së tij në Asambленë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, se sot liria e shprehjes kërcënohet nga përdorimi si armë i fuqisë së shpërndarjes.

Sipas kryeministrit Edi Rama, kur gënjeshtra shumëfishohet miliarda herë, e vërteta nuk ka nevojë të censurohet, pasi sipas tij, ajo varroset.



"Dy fqinj mund të jetojnë në të njëjtën rrugë, të votojnë në të njëjtat palë zgjedhesh dhe të

jetojne brenda realiteteve kryekeput te ndryshme, secili prej te cileve eshte prodhuar specifikisht per secilin prej tyre. Kur kjo ndodh, demokracia nuk humbet thjesht një debat apo thjesht një radhë zgjedhjesh, humbet terrenin e përbashkët mbi të cilin bëhet i mundur debati dhe humb edhe mundësinë për ta pasur atë. Sovraniteti nuk gërryhet më në kufi, gërryhet nëpër “feed-e”. Në shekullin e XX-të sovraniteti kuptonte kontrollin për tokën, ujërat territoriale dhe hapësirën kombëtare ajrore. Sot në Europë ne po vrapojmë si të marrë për të shtuar gjithmonë e më shumë, për të hedhur gjithmonë e më shumë para që nuk i kemi për të mbrojtur tokat tona, për të mbrojtur qiejt tanë nga një luftë e mundshme në të ardhmen, por disi po harrojmë që në shekullin që jetojmë, duhet që kjo të nënkuptojë edhe aftësinë e një shoqërie të lirë për të mbrojtur kushtet në të cilat qytetarët e saj formojnë opinionin e vet. Pa këtë aftësi, sovraniteti mbi tokën, mbi qiejt bëhet thjesht një iluzion e pastaj vjen shtresa e tretë; shpërndarja.

Për shekuj të tërë kërcënimi më i madh ndaj lirisë së fjalës ishte censura. Sot, liria e fjalës kërcënohet po kështu nga përdorimi si armë i lirisë së shpërndarjes. Fjala është e drejta për të shprehur një ide, shpërndarja është fuqia për ta vënë këtë ide përpara miliona njerëzve. Fjala i përket qenies njerëzore. Shpërndarja mund të blihet, automatizohet, të manipulohet dhe të caktohet fshehtësisht të vendoset fshehtësisht nga platformat, korporatat, zriat

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.